

VENDIM
Nr. 660, datë 27.8.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIM I ISH-PARKUT KUÇOVË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim i ish-Parkut Kuçovë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 52 609 731 (pesëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 52 609 731 (pesëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Kuçovë.
 8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Kuçovë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Kuçovë.
 9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Kuçovë.
 10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kuçovë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTI “NDËRTIM ISH PARKUT KUÇOVË”

NR.	VENDN DODHJA	Emri Mbiemri i pronarit	TË DHËNAT E PASURISË				LLOJI I PRONËS	LLOJI I PRONËS		Sipërfaqe për shpronësim (m2)	Çmimi truall lekë/m ²	Vlera në lekë për Truall	Sipërfaqe për shpronësim (m2)		Çmimi mesatar i banesës /apartamentit nga ZRPP 36000 minus vlerën e tokës 2040	VLERA PËR NDËRTESE	OBJEKTE TË TJERA	VLERA TOTALE PËR SHPRONËSIM (LEKË)	Shënim
			Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Volumi	Faqe	Tokë	Ndërtesë		Tokë			Ndërtesë		36000-2040				
							Truall	Banim	Shërbim	Truall			Banim	Shërbim					
1	KUCOVË	Vasil Simon Gjika dhe Katerina Leksi Gjika	2310	6/159+1-2	23	117		55					55		33960	1,867,800		1,867,800	
2	KUCOVË	Alin Avdyll Malaj	2310	6/561	41	130	160	55	105	160	2040	326,400	55	105	33960	6,810,076		7,136,476	
3	KUCOVË	Alin Avdyll Malaj dhe Anduela Thoma Malaj	2310	6/561+1-1	42	42		134.9					134.9		33960	4,581,204		4,581,204	
4	KUCOVË	Arben Izet Tabaku	2310	6/194-ND	18	46	-		50	-				50		1,008,088		1,008,088	
5	KUCOVË	Arjan Haxhem Qato	2310	6/196	26	219	239		115	239	2040	487,560		115		1,639,394		2,126,954	
6	KUCOVË	Adrian Vasil Shuka, Denada Vasil Shuka dhe Sokol Vasil Shuka	2310	6/156-ND2	17	213	-		2145	-						5,785,479		5,785,479	
7	KUCOVË	Donika Kastriot Tafili dhe Elton Shpëtim Tafili	2310	6/207	42	2	134	14.6	18.5	134	2040	273,360	14.6	18.5	33960	908,054		1,181,414	
8	KUCOVË	Ligor Sifit Rogozi	2310	6/168-ND	25	117	-		61	-				61		954,300		954,300	urdhër kufizimi
9	KUCOVË	Murat Ali Benja	2310	6/314	29	64	2713		1025	2713	2040	5,534,520		1025		11,626,692	8,440,909	25,602,121	urdhër kufizimi
10	KUCOVË	Vangel Jani Pjetri	2310	6/197	26	240	173		65.6	173	2040	352,920		65.6		1,515,653		1,868,573	
11	KUCOVË	Vasil Simon Gjika	2310	6/209	27	75	94		18	94	2040	191,760		18		305,562		497,322	
TOTALI										3513		7,166,520				37,002,302	8,440,909	52,609,731	

Shënim:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për ndërtesën, vlera është llogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërbllimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, ku çmimet janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave.